

FILOZOFI DHE SOCIOLOGJI

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Sociologji

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 8	C	1 pikë
Pyetja 10	A	1 pikë
Pyetja 12	C	1 pikë
Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë

Pyetja 3 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- Normë udhëzuese.
- Kjo normë për mënyrën e veshjes në këtë rrethanë sociale nuk i detyron individëve se çfarë duhet të bëjnë, por i udhëzon në bazë të një etike veshje për të respektuar këtë ritual.

2 pikë nëse përcakton dhe shpjegon;

OSE

1 pikë nëse përcakton;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- Mësojnë të ndërveprojnë me njerëz të tjerë të cilët mund të jenë të ndryshëm në aspektin racor, gjinor, nënkulturor, etj. Zhvillojnë aftësi të punës në grup.
- Edukimi i vlerave të rëndësishme si barazia, konkurrenca, optimizmi, respektimi i lirisë së tjetrit, etj.
- Programi mësimor i fshehtë që lidhet me zhvillimin dhe promovimin e talentëve të reja në prezantime, zhvillimin e lidhshimit, etj.
- Nxënësit aftësohen në aspektin intelektual. Ata marrin njohuri në fusha të ndryshme duke u aftësuar për tregun e punës dhe zhvillim personal.
- Zhvillojnë aftësi për të mësuar dhe për t'u përshtatur vlerave të shoqërisë në të cilën jetojmë.
- Mësimi i organizimit burokratik, një regjimi të organizuar që kërkon të përshtatet për të qënë pjesë e shoqërisë. Përcaktimi dhe respektimi i kufijëve, kritereve të sjelljes, sanksioneve etj.

- 2 pikë nëse shpjegon dy funksione;
OSE
1 pikë nëse shpjegon një funksion;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 6

3 pikë

Model përgjigjeje

- Pohimi i vlerave kulturore- shoqërisht përcaktohet çfarë është e drejtë, e moralshme, e gabuar dhe reagimi i pasagjerëve ndikon për të pohuar këto vlera. Respektimi i normave ka një rëndësi të madhe për funksionimin e shoqërisë. Kjo sjellje deviante ndikojnë duke rritur vetëdijen e anëtarëve të shoqërisë për rëndësinë e normave dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ndikojnë në shoqërizim.
- Përcaktimi i kufijëve moralë- ballafaqimi me situata të tilla të deviancës rritet edhe një herë kufijtë moralë të cilët shërbejnë si elementë orientuese të kohezionit shoqëror.
- Forcimi i unitetit- sanksionimi shoqëror që bëjnë pasagjerët ndaj sjelljes së vajzës adoleshente veprojnë në mënyrë të unifikuar duke forcuar solidaritetin dhe bashkëpunimin midis tyre.

- 3 pikë nëse shpjegon tre funksione;
OSE
2 pikë nëse shpjegon dy funksione;
OSE
1 pikë nëse shpjegon një funksion;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 7

3 pikë

Model përgjigjeje

- Arritja e barazisë ndërgjinore. Inkurajimi i përmirësimit të statusit të vajzave dhe grave në shoqëri, në teori dhe praktikë.
- Zhvillimi i tipareve njerëzore, pa kategorizime për vajzat, gratë dhe djemtë e burrat.
- Tejkalmimi i shtresëzimit gjinor në nivel mendësie, politike që ndikon negativisht të vajzat dhe gratë, në arsimim, punësim etj; Eliminimi i diskriminimit.
- Ndryshim i normave kulturore dhe ligjore për mundësi të barabarta në votim, të drejtën e pronës, arsimim, punësim, përparim në karrierën profesionale, politike, shoqërore.
- Shmangia e akteve të dhunës. Ndryshimi i mendësisë dhe praktikave lidhur me format e abuzimit seksual.
- Liria e orientimit seksual.
- Përkrahja e kontrollit të vajzave dhe grave mbi seksualitetin dhe riprodhimin.
- Etj.

- 3 pikë nëse përcakton tri objektiva;
OSE
2 pikë nëse përcakton dy objektiva;
OSE
1 pikë nëse përcakton një objektiv.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetje 9

2 pikë

Model përgjigjeje

- a) Forma e marrëdhënieve mes shumicës dhe pakicës në këtë rast bazohet tek veçimi (segregacion racor; shprehet si shpërfillje, përçmim, diskriminim).
- b) Veçimi në këtë rast shprehet si veçim fizik dhe shoqëror. Tregon pamundësinë për të qënë pjesë e një skene që nuk rezervohej për personat me ngjyrë. Personat me ngjyrë trajtoheshin në mënyrë armiqësore, përçmoheshin e shpërfilleshin, pavarësisht talentit. Diferencimi në përdorimin e mjediseve dhe pamundësia për të qënë pjesë e orkestrës klasike tregojnë për diskriminimin që bëhej ndaj personave me ngjyrë. Personat me ngjyrë në këto shoqëri diskriminuese mund të punësoheshin në pozicione me profil të ulët.

2 pikë nëse përcakton dhe vlerëson;

OSE

1 pikë nëse përcakton ose vlerëson;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11

2 pikë

Model përgjigjeje

- Fundamentalizmi shfaqet si një përpjekje për t'i bërë ballë ndryshimeve të mëdha në shoqëri, si ndryshimi i mendësive dhe mënyrave tradicionale të jetës, duke synuar të respektojë në mënyrë të rreptë parimet fetare e duke ruajtur besimin fetar në formën tradicionale, konservatore.
- Duke qenë se shekullarizimi reflektohet si ulje e ndikimit të organizatave fetare, këto lëvizje fundamentaliste kërkojnë ta sjellin besimin në trajtë të pastër e t'u kundërvihen praktikave të liberalizmit, që lidhen me ndryshimet e shpejta shoqërore e kulturore.
- Prirjet shekullarizuese kanë bërë që praktikat fetare të thjeshtohen, duke i ikur kështu elementëve themelor të ruajtës së fesë që predikojnë fundamentalistët, për këtë ata bëjnë përpjekje të ruajnë tiparet konservatore të fesë.
- Përpjekja për të ruajtur besimin fetar në formën tradicionale nën "kërcënimin" e ndikimit të masivizimit të arsimit dhe njohurive shkencore.

2 pikë nëse shpjegon dy arsye;

OSE

1 pikë nëse shpjegon një arsye;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13**2 pikë****Model përgjigjeje**

- Jeta në qytet është më dinamike në marrëdhëniet shoqërore, takimet janë të shumta, por ato janë sipërfaqësore. Këta banorë përgjithësisht kultivojnë qëndrime të zbehta, shprehej sociologu Zimel, pra orientojnë vëmendjen ndaj çështjeve që lidhen me interesin vetjak. Kjo shkallë indiferentizmi që kanë për shkak të jetës së vullshme i bën më të shkujdesur.
- Jeta në qytet karakterizohet nga lidhjet me solidarësi shoqërore të dobët, sipas sociologut Tënis. Shumëllojshmëria e shoqërisë dhe mungesa e identitetit të përbashkët për shkak të nënukurave e kulturave të ndryshme ndikon në krijimin e marrëdhënieve më të zbehta midis njëri-tjetrit.
- Karakteristikë për banorët e qytetit janë marrëdhëniet shoqërore që karakterizohen nga një shkallë e madhe jopersonale dhe lidhjet janë përgjithësisht të përkohshme, të përcaktuara nga një pavëmendje sociale.
- Për shkak të një ritmi jetese shumë të vullshëm dhe kontakteve të shtuara me njerëz të ndryshëm, banorët e qytetit prirën të zhvillojnë qëndrime më indiferente. Njerëzit ndonëse jetojnë pranë njëri-tjetrit kanë shumë pak ndërveprim dhe lidhjet janë të dobëta.
- Etj.

2 pikë nëse prezanton dy argumenta;
OSE

1 pikë nëse prezanton një argument;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 15**2 pikë****Model përgjigjeje**

- Këto lëvizje reformuese synojnë të realizojnë ndryshime të kufizuara në shoqëri të caktuara.
- Këto lëvizje kërkojnë të ofrojnë barazi ekonomike, shoqërore, të respektojnë të drejtat, të përmirësojnë legjislativonin.
- Synojnë përmirësimin e kushteve dhe emancipimin e vajzave dhe grave.
- Këto lëvizje janë lëvizje përparimtare, që kërkojnë të reformojnë mënyrën e të menduarit dhe sjelljet.
- Këto lëvizje reformuese, ndryshojnë mendësitë dhe kontribuojnë në zhvillimet demokratike.

2 pikë nëse vlerëson dy synime;
OSE

1 pikë nëse vlerëson një synim;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19**2 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Pjesëmarrës
- b) Studiuesit jetojnë në bashkësitë e grupeve shoqërore që studiojnë, duke u përfshirë kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimtaritë e tyre (ushqehen, sillen dhe vishen në mënyrë të përshtatshme për grupin që studiojnë). Studiuesit mund të tregojnë rolin e tyre ose ta mbajnë të fshehtë.
- Në përgjithësi kur studiuesit nuk prezantojnë qëllimin e tyre, sjelljet e njerëzve shfaqen ashtu siç janë, të pamodeluara sipas pritshmërive.
 - Në disa raste ka rëndësi të prezantohet roli që kanë studiuesit dhe të fitohet besimi e mirëkuptimi i ndërsjelltë për të vijuar realizimin e qëllimit të studimit.
 - Studiuesit kërkohet të arrijnë një shkallë të caktuar mirëbesimi me grupin që do të studiojnë pasi vetëm në kushte të tilla mund të marrin të dhënat e nevojshme për studim.

2 pikë nëse përcakton dhe shpjegon;
OSE
1 pikë nëse përcakton ose shpjegon;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Filozofi

Pyetja 23	A	1 pikë
Pyetja 24	A	1 pikë
Pyetja 25	B	1 pikë
Pyetja 26	D	1 pikë
Pyetja 29	C	1 pikë
Pyetja 30	B	1 pikë
Pyetja 31	C	1 pikë
Pyetja 33	D	1 pikë
Pyetja 34	B	1 pikë
Pyetja 35	C	1 pikë

Pyetja 20

2 pikë

Model përgjigjeje

Sipas Aristotelit:

- Etika: njeriu për Aristotelin duhet të synojë lumturinë, të jetojë si qytetari i lirë dhe i përgjegjshëm. Forma më e lartë e shprehjes së lumturisë realizohet kur veprimtaria e shpirtit është në përputhje me virtytin. Lumturia arrihet përmes ushtrimit të virtytit si guximit, bujarisë, drejtësisë, miqësisë, qytetarisë dhe larg pasioneve që lidhen me lakminë, urrejtjen etj.

- Mesi i artë:

- ekuilibri është mesi i artë;

- virtyti duhet t'i përmbahet rregullit të artë;

- meqënëse pasionet janë në masa të ndryshme, njeriu duhet të zbulojë masën e duhur pa teprim dhe mungesë të veprimit; të ndjejë aq sa duhet dhe atëherë kur duhet;

- virtytet janë kurajo, maturaia, drejtësia, toleranca, miqësia, vetëbesimi, nuk ka mes të artë për pasione dhe veprime të tilla si: inati, zilia, vjedhja, vrasja etj.

- mesi është relativ dhe i ndryshëm për çdo person, por çdo person mund ta gjej mesin e tij.

- 2 pikë nëse përshkruan dy aspekte;
OSE
1 pikë nëse përshkruan një aspekt;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 21

3 pikë

Model përgjigjeje

Bota e ideve:

- Është realiteti i vërtetë.
- Është e përgjeshme, ekziston përtej kohës dhe hapësirës
- Njihet përmes arsyes.
- Përmban sendet në formë të kulluar.
- Përmban forma të pandryshueshme.
- Etj.

Bota e shqisave:

- Ndryshon pareshtur/pandërprerë.
- Nuk është e përgjeshme.
- Kopje e papërsosur e formave në "botën e ideve".
- Etj

Reminishenca:

- Të rikujtosh përmes procesit të arsyes.
- Njohuria ka gjenezën përpara se ne të lindim ndaj pas lindjes ne zgjojmë kujtimet.

- 3 pikë nëse shpjegon tre aspekte;
OSE
2 pikë nëse shpjegon dy aspekte;
OSE
1 pikë nëse shpjegon një aspekt;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 22

3 pikë

Model përgjigjeje

- Përmes këtij formulimi epikurianët kërkonin të largonin frikën nga vdekja, në mënyrë që njerëzit të jetonin jetën në plotësi e pa kufizime.
- Epikurianët konkludonin se Zoti nuk është krijues i botës.
- Zoti edhe nëse ekziston nuk kontrollon jetën e njerëzve. Për këtë arsye njerëzit nuk duhet të turbullohen nga frika prej perëndi-së/ve.
- Nuk ekziston jeta e përtejme.

- Pas vdekjes nuk ka ndjesi, vdekja ekziston si koncept vetëm për tjetrin.
- Pas vdekjes atomet e trupit dhe mendjes ktheheshin në gjendjen fillestare për të krijuar sende e trupa të tjerë.
- Lu kundërvunë supersticionit dhe orientuan vëmendjen ndaj një ftese për të gëzuar jetën.
- Promovonin të shijuarit e jetën përmes vetëkontrollit.
- Etj.

- 3 pikë** nëse shpjegon tre qëndrime;
OSE
2 pikë nëse shpjegon dy qëndrime;
OSE
1 pikë nëse shpjegon një qëndrim;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 27

3 pikë

Model përgjigjeje

- Njeriu do të udhëhiqej nga vlera të cilat do t'i përcaktonte. Nuk do të jetonte për hir të Zotit, por do të jetonte e gëzonte në të tashmen.
- Njeriu po shihej si farkëtues i fatit të tij, ai zotëron jetën dhe përmes aryes dhe mendimit kritik kishte potencialin për të progresuar.
- Njeriu po skicohej si individ unik. Një qenie e angazhuar në shkencë, art, letërsi.
- Njeriu ka më shumë qasje në botime (shtypshkronja e parë nga Gutenberg, në vitin 1450), të cilat ndikuan në rritjen e nivelit të kulturës. Duke krijuar mundësi për shkëmbime kulturore dhe zhvillimin e kulturës së debatit midis shkrimtarëve.
- Njeriu është pikësynimi dhe pikënisja e cdo veprimtarie teorike dhe praktike.
- Njeriu karakterizohet nga dashuria dhe respekti për tjetrin.
- Zbulimet shkencore mbi botën ndryshuan mënyrën e perceptimit mbi individin dhe vetë jetën.
- Zbulimet e reja gjeografike krijuan mundësinë e njohjes së traditave të kulturave të tjera, të aspekteve shoqërore dhe politike, duke krijuar një qasje të re perceptimi.
- Diskutimi dhe zhvillimi i temave që lidhen me lirinë, dinjitetin dhe të drejtat e njeriut zhvilluan mendimin kritik dhe ndikuan në formësimin e njeriut.
- Etj.

- 3 pikë** nëse shpjegon tri karakteristika;
OSE
2 pikë nëse shpjegon dy karakteristika;
OSE
1 pikë nëse shpjegon një karakteristikë;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Model përgjigjeje

- Xhon Loku, filozofi liberal që mbështeste të drejtat dhe liritë natyrore të njeriut (liria e mendimit, tolerancë në besimin fetar, barazi midis burrit dhe gruas, e drejta e pronës, etj.)
- Njerëzit “nënshkruan” kontratën shoqërore për të krijuar shtetin në mënyrë që të garantoheshin të drejtat. Me daljen nga gjendja e natyrës dhe krijimin e shtetit është populli që zgjedh përfaqësuesit e tij.
- Me “nënshkrimin” e kontratës shoqërore, ligjet do të përcaktonin standardet e gjykimit për çështje të caktuara, ndryshe nga gjendja e natyrës në të cilën vepronin gjykimet vetjake, subjektive. Respektimi i ligjeve që respektojnë parime të standardizuara të së drejtës janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike.
- Loku bëhet promotor i ndarjes së pushtetit (legjislativ, ekzekutiv, federativ), në mënyrë që të kishte një qeverisje të drejtë, jo të korruptura, jo tiranike. Pushteti legjislativ do të kishte peshën kryesore meqënëse zgjidhet nga shumica e popullit.
- Xhon Loku kundërshtoi teorinë e qeverisjes së mbretërve në bazë të të drejtës hyjnore, duke argumentuar se të gjithë njerëzit lindin me të drejta natyrore si e drejta për jetën, lirinë, pronën .
- Shteti duhet të mbroj të drejtat dhe liritë e njeriut. Në rast se kjo nuk ndodh, sundimtarët mund të largohen forcërisht nga rebelimi masave.
- Përligjja e rezistencës si një masë ndaj padrejtësive në politikbërje, në këtë mënyrë përligj rebelimin e njerëzve në kushtet kur qeveria nuk i shërben interesave të shumicës.
- Promotor i bashkëjetesës, tolerancës fetre dhe politike.
- Shteti duhet të ketë karakter laik, ndarje të shtetit nga kisha.
- Etj.

2 pikë nëse vlerëson dy parime;

OSE

1 pikë nëse vlerëson një parim;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Model përgjigjeje

- Me lindjen e pronës private kemi një marrëdhënie konfliktuale të “luftës së të gjithëve ndaj të gjithëve”. Kjo pabarazi sociale që vjen si shkak i pronës është shumë problematike dhe ndan shoqërinë në të varfër dhe të pasur.
- Prona private është kundër ligjit të natyrës. Për Rusoin është e papranueshme që të ekzistojnë një grup njerëzish që zotëron pa mugesë dhe një tjetër grup të cilit i mungojnë gjërat e domosdoshme.
- Me lindjen e pronës private jeta sociale lidhet në marrëdhënie varësie me zhvillimin ekonomik.
- Lindja e pronës private dëmton gjendjen e natyrshme të njerëzimit.
- Lindja e pronës private krijoi nevojën për të zhvilluar një sistem që do ta mbronte atë.

- Etj.

2 pikë nëse vlerëson dy rrjedhoja;
OSE

1 pikë nëse vlerëson një rrjedhojë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 38

2 pikë

Model përgjigjeje

Hajdeger shprehet se ekzistenca e njeriut karakterizohet nga:

Përgjegjësinë

- Njeriu hidhet në këtë botë, pra nuk e zgjedh se ku, nga kush dhe kur do të vijë në jetë.
- Kur vjen në këtë botë, atij i duhet të marrë vazhdimisht vendime për të krijuar veten dhe marrëdhëniet me të tjerët dhe kjo është përgjegjësia e tij. Askush tjetër nuk mund të vendosë në emër të tij.
- Meqenëse vjen vetëm njëherë në jetë, njeriu përpiqet të bëjë gjëra që janë origjinale dhe e dallojnë nga të tjerët.
- Njeriu ka plane për të ardhmen, cilësia e të cilave e bën të dallueshëm dhe i jep kuptim jetës së tij.

Ankthin

- Çdo zgjedhje që bëjmë na përcakton si individë dhe kjo barrë e përgjegjegjësisë, që njeriu i lirë duhet të mbajë, i shkakton atij, një ankth të vazhdueshëm.
- Ankthi vjen kur njeriu (jaqenia ose Dasein), zbulon dramën e kotësisë së qëllimeve të tij, sepse është një qenie e vdekshme. Njeriu e kupton fundin e ekzistencës së çdo gjëje, edhe të vetvetes.
- Ankthi shkaktohet edhe kur njeriu kupton se është i kërcënuar nga të tjerët, i veçuar, i trembur nga të panjohurat e jetës dhe nga normat morale që i janë rrenjosur brenda vetes.

Daseinin

- Dasein (jaqenia, qenia atje), është e vetmja pjesë e qenies që mendon për qenien. Ai jeton brenda botës dhe kohës që e rrethon dhe marrëdhënieve që ka me njerëzit e tjerë.
- Dasein përfaqëson një proces që ndodh vetëm te njeriu. Kjo qenie nuk mund të trajtohet si e shkëputur nga pjesa e botës në të cilën ajo jeton.
- Dasein përfaqëson qenien si të vetmen që mund të vendoset si mendërisht e fizikisht përballë vetes si përpara pasqyrës dhe të shrehet: ja ku është qenia ime!
- Dasein përfaqëson njeriun dhe tërësinë e marrëdhënieve që ai ka në botë, të cilat e kushtëzojnë ne veprimet e tij.
- Përfaqëson aspektin reflektues të qenies, me të cilën flet si për një person tjetër.
- Dasein përfaqëson një qenie të vazhdueshme që mediton, gjendjen e njeriut në këtë botë dhe kuptimin e të banuarit në të.
- Etj.

- 2 pikë nëse analizon përgjegjësinë dhe ankthin;
OSE
1 pikë nëse analizon përgjegjësinë ose ankthin;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep një përgjigje që nuk e përmban modeli i skemës së vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.
